



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
ZËDHËNËSI**

06.06.2016

BASHKIA SKRAPAR

KLSH Kallëzon në Prokurori 3 anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe 2 Mbikëqyrës të Punimeve, për Procedura fiktive në prokurime dhe favorizimin e operatorëve, duke i shkaktuar shtetit dëm në vlerën 26,2 milionë lekë.

Kontrolli i Lartë të Shtetit, në zbatim të programit të tij të auditimit nr. 1196/1, datë 31.12.2015, ka përfunduar auditimin në Bashkinë Skrapar, me objekt: “*Auditimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare për vitin 2013-2015*”.

Me Vendimin nr. 49, datë 08.05.2016 të Kryetarit të KLSH-së është miratuar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 1196/14 datë 13.05.2016 i janë rekomanduar Bashkisë Skrapar masa me karakter organizativ dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar në vlerën totale 26,2 milion lekë.

Gjatë auditimit u konstatuan disa shkelje dhe parregullsi të dispozitave ligjore në fuqi. Në përgjithësi këto shkelje e parregullsi, konsistojnë në për kryerjen e procedurave të paligjshme në prokurime dhe zbatimin e kontratave me qëllim favorizimin e operatorëve ekonomikë të caktuar. Konkretisht:

Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit “*Ndërtim i unazës Jug-lindore të qytetit Çorovodë*”, është shkelur parimi i përzgjedhjes së ofertave, duke diskriminuar e trajtuar në mënyrë të pabarabartë ofertuesit, duke mos zbatuar kriterin themelor të prokurimit “*Oferta më e ulët*” dhe duke skualifikuar pa të drejtë operatorin ekonomik me ofertën më të ulët. Nga skualifikimi i operatorit me ofertë më të ulët buxhetit të shtetit dhe njësisë të qeverisjes vendore i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej **7,7 milion lekë**.

Mbikëqyrësit e punimeve të objekteve “*Ndërtimi i Unazës së Qytetit të Çorovodës (segmenti Jug-Lindor)*”, “*Ndërtimi i Unazës së Qytetit të Çorovodës (segmenti Jug-Lindor) dhe “Ndërtimi i Unazës së Qytetit të Çorovodës (segmenti Jug-Lindor)*”, kanë raportuar për punime të cilat kanë rezultuar të pakryera por të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave, apo kanë dubluar zërat e punimeve, duke sjellë për pasojë likuidimin nga Bashkia Skrapar të punimeve të pa kryera apo paguar dy herë për të njëjtat zëra punimesh, në dëm të buxhetit të njësisë të qeverisjes vendore në **vlerën 18,5 milion lekë**.

KLSH, duke i konsideruar veprimet e kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), **F.T** (Ish-NënKryetarit të Bashkisë dhe Kryetar i KVO), **N.G.** (Drejtor i Financës dhe anëtar i KVO), dhe **B.M.** (Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit Urban dhe anëtar i KVO), si dhe Mbikëqyrësit e Punimeve **I.K.** dhe **V.A.** si veprime me pasoja të rënda për interesat e ligjshme të shtetit dhe të dënueshme sipas ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*”, me shkresë nr. 1196/17, date 31.05.2016, ka bërë kallëzim pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Berat, për kryerjen e procedurave fiktive në prokurime dhe zbatimin e kontratave me qëllim favorizimin e operatorëve ekonomikë të caktuar, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 26,2 milionë lekë, dhe për pasojë kanë konsumuar elementët e figurës së veprave penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” dhe “*Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, parashikuar nga nenet 248 dhe 258 të Kodit Penal.

V.O. Në web-in e KLSH gjendet i plotë Vendimi nr. 49, datë 08.05.2016 në lidhje me këtë auditim.